



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I TRASHËGIMISË KULTURORE TURIZMIT DHE ARTIT

KRYETARI

Nr. ____ Prot

Maliq, më 22.02.2024

Projekt Vendim - Nr. 12

PER NDRYSHIM NË KOMISIONIN KESHILLIMOR

"Për shqyrtimin e Titujve të Nderit, Kriteret dhe Procedurën e Dhënies së tyre"

Në mbështetë të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, neni 54, "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma "a" dhe "k", nenit 55 pika 6, neni 64 "Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë" gërma "c", ligjit nr. 112/2013 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr 86 l datë 10.02.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve Këshillimore për dhenien e Medaljeve dhe Titujve Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë ", kërkojmë ndryshime në Komisionin Këshillimor, si më poshtë:

- 1- Miratimin e emrave për antarë të Komisionit Këshillimor, të një N/Kryetari të Këshillit të Bashkisë, dhe dy anëtarëve të Këshillit të Bashkisë.
- 2- Shtesë në Komisionin Këshillimor të një punonjësi të Trashëgimisë Kulturore.

PËRGJEGJËSI

Festim Tomorri

KRYETARI

Gëzim TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 322 Prot

Maliq, më 11.06.2021

VENDIM

Nr 39, datë 11.06.2021

**PËR MIRATIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR
“Për shqyrtimin e Titujve të Nderit, Kriteret dhe Procedurën e Dhënies së tyre”**

Këshilli Bashkiak Maliq në mbledhjen e tij të datës 11.06.2021, me propozim të Drejtorisë të Trashëgimisë Kulturore Turizmit dhe Arteve, për dhëniën e Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Maliq, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, neni 54, “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” gërma “a” dhe “k”, nenit 55 pika 6, neni 64 “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë” gërma “c”, ligjit nr. 112/2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr 861 datë 10.02.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve Këshillimore për dhëniën e Medaljeve dhe Titujve Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, pas diskutimeve dhe propozimeve këshilli i bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e Komisionit Këshillimor “Për shqyrtimin e llojeve e titujve të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre”, me përbërje, si më poshtë:
 1. Kryetari i Bashkisë (Kryetar Komisioni)
 2. Nën/Kryetar Këshilli (Nën/Kryetar Komisioni)
 3. Drejtori i Drejtorisë të Trashëgimisë Kulturore Turizmit dhe Arteve (Sekretar)
 4. Përfaqësues i Drejtorisë Juridike, Burimet Njerzore, Prokurimet Publike në Bashki
 5. Anëtar Këshilli
 6. Anëtar Këshilli
 7. Përfaqësues Organizata e Veteranve
 8. Përfaqësues Organizata e familjeve të Dëshmorëve
 9. Përfaqësues Shoqëria Civile
 10. Përfaqësues Arsimit (Mësues Historie)
 11. Përfaqësues Arsimit (Mësues Historie)
2. Për zbatimin e vendimit dhe zbardhjen e Urdhërit me emrat përkatës ngarkohet Kryetari i Bashkisë si drejtes i Komisionit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 322 Prot

Maliq, më 11.06.2021

VENDIM

Nr 40, datë 11.06.2021

MIRATIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR

“Për shqyrtimin e Titujve të Nderit, Kriteret dhe Procedurën e Dhënies së tyre”

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, neni 54, “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” gërma “a”, nenit 55 pika 6, pas diskutimeve dhe propozimeve këshilli i bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e anëtarve të Komisionit Këshillimor të Këshillit Bashkiak “Për shqyrtimin e llojeve e titujve të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre”, me përbërje, si më poshtë:
 1. znj.Gentiana Drabo
 2. znj.Floreta Zaçe
 3. znj.Valentina Pashollari
2. Komisioni Këshillimor “Për shqyrtimin e llojeve e titujve të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre”, do të jëtë pjesë përbërse e Komisionit më të njëjtin emër ngritur me Urdhrër të Kryetarit të Bashkisë Maliq.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornilda DEMOLLARI

